



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

|           |   |  |
|-----------|---|--|
|           | Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo                 |  |
|           | KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS<br>SUDSKI SAVET KOSOVA<br>KOSOVO JUDICIAL COUNCIL |  |
| Nr.Br.No. | 01 / 1100   |  |
| DATA      | 29.07.2022  |  |
|           | PRISHTINË - A   |  |

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.24 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 18 dhe 36 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, nenit 28 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, nenit 25 të Rregullorës Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr. KO 203/19, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 korrik 2022,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 07/2022**  
**PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E**  
**VENDEVE TË PUNËS NË GJYKATËN KOMERCIALE**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave lidhur me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Komerciale.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1. “Ligj”- Ligji Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale;

- 1.2. **“Këshilli”**- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.3. **“Gjykata Komerciale”**- siç parashihet në Ligjin Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale;
- 1.4. **“Dhomat e shkallës së parë”**- janë kompetente për të shqyrtuar dhe gjykuar në shkallë të parë nga gjyqtari individual të gjitha çështjet në kompetencë të Gjykatës Komerciale, ekuivalente me Gjykatat Themelore;
- 1.5. **“Dhomat e shkallës së dytë”**- janë kompetente për të shqyrtuar dhe gjykuar në shkallë të dytë të gjitha çështjet në kompetencë të Gjykatës Komerciale, ekuivalente me Gjykatën e Apelit.
- 1.6. Fjalët e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

### **Neni 3 Përgjegjësia për zbatim**

1. Për zbatimin e drejtë të kësaj rregullore është përgjegjës Kryetari i Gjykatës Komerciale, administratori dhe këshilltari Ligjor.
2. Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Komerciale janë të detyruar t'i përmbahen kësaj rregullore.
3. Mbikëqyrjen për zbatimin e drejtë të kësaj rregullore e bën Këshilli.

### **Neni 4 Selia e Gjykatës Komerciale**

Selia e Gjykatës Komerciale është në Prishtinë.

## **KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

### **Neni 5 Gjykata Komerciale**

1. Gjykata Komerciale gjykon çështjet brenda kompetencës së saj, me juridiksion për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe organizohet si në vijim:

- 1.1. Dhomat e shkallës së parë; dhe
- 1.2. Dhomat e shkallës së dytë.

2. Dhomat e shkallës së parë janë kompetente për të shqyrtuar dhe gjykuar në shkallë të parë nga gjyqtari individual të gjitha çështjet në kompetencë të Gjykatës Komerciale, ekuivalente me Gjykatat Themelore.

3. Me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre, dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale përbëhen nga:

- 3.1. Departamenti për Çështje Ekonomike;
  - 3.1.1. Divizioni për investitorët e huaj;
- 3.2. Departamenti i Përgjithshëm;
- 3.3. Departamenti Fiskal;
- 3.4. Departamenti për Çështje Administrative;

4. Kryetari i Gjykatës Komerciale, në bashkëpunim me gjyqtarët e gjykatës, mund të vendosë për themelimin e divizioneve të specializuara në dhomat e shkallës së parë.

5. Departamentet sipas paragrafit 3 të këtij neni, do të trajtojnë çështjet brenda kompetencave të përcaktuara me Ligj.

6. Dhomat e shkallës së dytë, janë kompetente për të shqyrtuar dhe gjykuar në shkallë të dytë në të gjitha çështjet në kompetencë të Gjykatës Komerciale, ekuivalente me Gjykatën e Apelit sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 6** **Struktura Organizative**

1. Struktura e brendshme organizative e Gjykatës Komerciale është si vijon:

- 1.1. Zyra e Kryetarit të Gjykatës;
- 1.2. Njësia Ligjore; dhe,
- 1.3. Zyra e Administratorit të Gjykatës.

2. Numri i të punësuarve në Gjykatën Komerciale përcaktohet nga Këshilli, në raport me ngarkesën e Gjykatës me lëndë.

## **Neni 7** **Zyra e Kryetarit**

1. Zyra e Kryetarit përbëhet nga:

- 1.1. Kryetari;

- 1.2. Nënkryetari;
- 1.3. Gjyqtarët e dhomave të shkallës së dytë;
- 1.4. Gjyqtarët e dhomave të shkallës së parë;
- 1.5. Këshilltari Ligjor (kreu i Njësisë Ligjore);
- 1.6. Administratori; dhe,
- 1.7. Zyrtari ekzekutiv.

2. Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionon edhe Zyra për Informim dhe Komunikim me Media.

3. Zyrtari ekzekutiv zgjedhet dhe emërohet nga kryetari i gjykatës dhe është përgjegjës vetëm para tij, për kryerjen e detyrave të punës.

4. Kohëzgjatja e kontratës së punës së zyrtarit ekzekutiv është me afat të caktuar dhe lidhet me mandatin e kryetarit të gjykatës, përveç nëse i njëjti lirohet nga detyra sipas kërkesës së Kryetarit apo sipas mënyrave të tjera të përcaktuara me ligj.

5. Zyrtari ekzekutiv ka të drejtën e pagesës ekuivalente me pagën e Zyrtarit Ligjor në gjykatë.

## **Neni 8 Kryetari i Gjykatës**

Kryetari i gjykatës përveç kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në Ligjin për Gjykatën Komerciale dhe legjislacionin përkatës në fuqi, është përgjegjës për administrimin ditor të gjykatës, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli.

## **Neni 9 Nënkryetari i Gjykatës**

Në mbështetje të Ligjit për Gjykatën Komerciale, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli, nënkryetari i gjykatës ushtron detyrat e kryetarit të gjykatës në mungesë të tij apo kur kryetari e ka të pamundur ushtrimin e detyrave të tij. Nënkryetari ushtron edhe detyra të tjera të cilat i delegohen me shkrim nga kryetari i gjykatës.

2. Mandati i nënkryetarit të Gjykatës Komerciale është i lidhur me mandatin e kryetarit përkatës.

## **Neni 10 Gjyqtarët**

Gjyqtarët ushtrojnë funksionin e tyre në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

## **Neni 11**

### **Zyra për Informim dhe Komunikim me Media**

1. Zyra për Informim dhe Komunikim me Media përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
  - 1.2. Zyrtar për Informim dhe Komunikim me Media;
2. Zyra është përgjegjëse për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me informimin e Mediave dhe Publikut për punët dhe aktivitetet e gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përshkrimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton kryetarit të gjykatës dhe Udhëheqësit të Zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun në Këshill.
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Kryetari në koordinim me Udhëheqësin e Zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun në Këshill.
  - 4.1. Vlerësimi i performancës së të punësuarit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës.

## **Neni 12**

### **Njësia Ligjore**

1. Njësia Ligjore është njësi organizative në Gjykatën Komerciale që i përgjigjet drejtpërdrejt kryetarit të gjykatës, e cila përbëhet nga:
  - 1.1. Këshilltari Ligjor i cili vepron si Kreu i Njesisë;
  - 1.2. Bashkëpunëtor Profesional;
  - 1.3. Zyrtar Ligjor/Sekretar Juridik; dhe,
  - 1.4. Zyrtar i Përkthimeve.
2. Njësia Ligjore është përgjegjëse për kryerjen e të gjitha detyrave të cilat përcaktohen me Ligjin për Gjykatën Komerciale, duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin efektiv të seancave gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Këshilli.
3. Këshilltarin Ligjor i cili vepron si kreu i Njesisë e emëron kryetari i gjykatës nga mesi i bashkëpunëtorëve profesional përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues.

4. Procedura e rekrutimit dhe përzgjedhjes së Këshilltarit Ligjor do të rregullohet me akt të veçantë normativ.
5. Këshilltari Ligjor për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton kryetarit.
  - 5.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Këshilltarit Ligjor.
6. Vlerësimi i performances së Këshilltarit Ligjor bëhet nga kryetari.
  - 6.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2, të këtij neni bëhet nga Këshilltari Ligjor, në konsultim me gjyqtarin që punon, dhe kryetarin e Gjykatës;
  - 6.2. Vlerësimi i performancës i të punësuarve të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.3 dhe 1.4 të këtij neni bëhet nga Këshilltari Ligjor.

### **Neni 13** **Administrata**

1. Administrata e Gjykatës Komerciale përbëhet nga:

- 1.1. Zyra e Administratorit;
- 1.2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve;
- 1.3. Zyra për Shërbime të Përbashkëta;
- 1.4. Zyra për Buxhet dhe Financa

### **Neni 14** **Zyra e Administratorit**

1. Zyra e Administratorit përbëhet nga:

- 1.1. Administratori;
- 1.2. Zyrtar Çertifikues;
- 1.3. Zyrtar i Personelit.

2. Administratori i gjykatës në pajtueshmëri me Ligjin, menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës, në bashkëpunim me kryetarin dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit, si dhe është përgjegjës ndaj kryetarit të gjykatës, për administrimin efikas dhe efektiv të gjykatës.
3. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 i përgjigjen dhe i raportojnë Administratorit.

4. Vlerësimi i performancës së Administratorit bëhet nga kryetari në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit.

4.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 bëhet nga administratori.

## **Neni 15**

### **Zyra për Menaxhimin e Lëndëve**

1. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
  - 1.2. Sektori për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim;
    - 1.2.1. Mbikëqyrës i Sektorit;
    - 1.2.2. Referent;
    - 1.2.3. Dorëzues;
  - 1.3. Sektori për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika;
    - 1.3.1. Mbikëqyrës i Sektorit;
    - 1.3.2. Referent;
    - 1.3.3. Arkivist i lartë;
    - 1.3.4. Zyrtari i Statistikës.
2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve është përgjegjëse për pranimin, regjistrimin, dorëzimin, menaxhimin, ekzekutimin, arkivimin, raportimin statistikor të lëndëve në gjykatë si dhe administrimin e rasteve të referuara për ndërmjetësim nga gjykata dhe organet administrative, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton administratorit.
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1 dhe nënparagrafi 1.3 pika 1.3.1 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës;
  - 3.2. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të këtij neni si dhe të punësuarit në paragrafin 1, nënparagrafi 1.3 pika 1.3.2, 1.3.3 dhe 1.3.4 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Mbikëqyrësit të Sektorit.
4. Vlerësimi i performancës të Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori.
  - 4.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1, dhe nënparagrafi 1.3 pika 1.3.1 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi e Zyrës;
  - 4.2. Vlerësimi i performancës i të punësuarve në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 si dhe të punësuarit në paragrafin 1, nënparagrafi 1.3 pika 1.3.2, 1.3.3, dhe 1.3.4 të këtij neni, bëhet nga Mbikëqyrësi i Sektorit.

**Neni 16**  
**Zyra për Shërbime të Përbashkëta**

1. Zyra për Shërbime të Përbashkëta përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
  - 1.2. Zyrtar i Teknologjisë Informativë;
  - 1.3. Operator i TV-së;
  - 1.4. Zyrtar i Logjistikës;
  - 1.5. Receptionsist; dhe,
  - 1.6. Vozitës.
2. Zyra për Shërbime të Përbashkëta është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative, logjistikes dhe transportit sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përshkrimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Administratorit të gjykatës.
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6, të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori.
  - 4.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1 nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës.

**Neni 17**  
**Zyra për Buxhet dhe Financa**

1. Zyra për Buxhet dhe Financa përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyres;
  - 1.2. Zyrtar Shpenzues;
  - 1.3. Zyrtar për të Hyra;
2. Zyra për Buxhet dhe Financa është përgjegjëse për të gjitha çështjet financiare të Gjykatës Komerciale sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përshkrimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Administratorit.
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të këtij neni i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës.



4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të zyrës bëhet nga Administratori.

4.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës.

#### **Neni 18**

#### **Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

1. Të gjitha aktet nënligjore që lidhen me etikën, punën, performancën dhe disiplinimin e gjyqtarëve të nxjerra nga Këshilli do të jenë të vlefshme për gjyqtarët e Gjykatës Komerciale.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet çdo akt tjetër normativ i cili është në kundërshtim me këtë rregullore.

#### **Neni 19**


#### **Organogrami**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është edhe Organorami i Gjykatës Komerciale.

#### **Neni 20**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



Albert Zogaj,

  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Date: 29. 07. 2022

# Organogrami i Gjykatës Komerciale

## GJYKATA KOMERCIALE

